



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 804/1 prot.

Tiranë, më 28. 05. 2024

### V E N D I M

**Nr. 158, datë 28. 05. 2024**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 112 Regj., datë 22.05.2024, të shtetasit A. M., kundër Prefektit të Qarkut Durrës, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të *bindjeve politike<sup>1</sup> dhe moshës*.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

### K O N S T A T O I:

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet si dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga subjekti ankues, A. M., citon ndër të tjera se: “... Kam qenë polic zjarrfikës në qytetin e Krujës nga data 26.06.2006 dhe jam larguar nga puna më datë 02.10.2014 për arsye kriter moshe. Kur kam filluar punë kam qenë 46 vjeç e 10 muaj, por kriteri i moshës ka qenë 35 vjeç.

... nuk ka qenë krejtësisht ky motivi, por ka qenë për arsye politike, gjë që provohet vitet e fundit të pushtetit aktual, që më hoqën mua dhe më kanë zëvendësuar me militantët e tyre. Nuk kanë plotësuar kriterin e moshës, duke qenë më të mëdhenj në moshë se unë. Këta persona janë:

- G. Xh. Sh., i datëlindjes 1971, ka filluar punë në 01.02.2022;
- I. H. D., i datëlindjes 1980, ka filluar punë në Nëntor të 2022;
- A. Q. T., i datëlindjes 1976, ka filluar punë pa diplomë Gjimnazi;
- K. K. N., i datëlindjes 1975;
- A. R. Sh., i datëlindjes 1974, është pranuar me diplomë fallco, Komandant Stacioni Zjarrfikës Krujë.

Ky është ligji 126 që më ka hequr mua A. M. dhe ky është ligji 126 që ka pranuar këta persona në punë...”.

<sup>1</sup> Referuar vërtetimit Nr. 18/ prot., datë 18.01.2023, të lëshuar nga Dega e Partisë Demokratike, Krujë, ankuesi është anëtar i saj që nga viti 1992.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

Gjithashtu, ankuesi thekson se e ka ushtruar rekurs në vitin 2017, në Gjykatën e Lartë, duke kundërshtuar vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe Gjykatës Administrative të Apelit, por nga ana e saj është vendosur mospranimi i rekursit.

Në përfundim të parashtrimeve të paraqitura nëpërmjet ankesës së tij, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit nga ana e Prefektit të Qarkut Durrës, për shkak të moshës dhe bindjeve politike.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune pranë Prefekturës së Qarkut Durrës dhe ka mbajtur detyrën Polic Zjarrfikës. Referuar Urdhrit nr. 42, datë 03.07.2006, të Prefektit të Qarkut Durrës “Për emërim në detyrë”, ankuesi është emëruar në këtë pozicion pune, më datë 03.07.2006. Përmes Urdhrit nr. 126/1, datë 02.10.2014, ankuesi është larguar nga detyra për shkak se pranimi i tij në Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 8766/2001 “Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe për Shpëtimin”.

Subjekti ankues duke mos qenë dakord më këtë vendimmarrje, e ka kundërshtuar atë në rrugë administrative fillimisht, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, e cila me vendimin nr. 251, datë 27.02.2015, ka vendosur: “Pranimin e pjesshëm të padisë së ngritur nga paditësi A. M. Detyrimin e palës së paditur ti paguajë paditësit A. M., pagën për pushimet vjetore të pakryera për periudhën 01.01.2014-02.10.2014. Rrëzimin e padisë në kërkimet e tjera si e pabazuar në ligj dhe në prova”.

Gjithashtu, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1620, datë 13.04.2017, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 251, datë 27.02.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës”.

Nëpërmjet Vendimit nr. 4771, datë 21.11.2023, Gjykata e Lartë, pasi e ka shqyrtuar në dhomë këshillimi çështjen, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse A. M., ndaj vendimit nr. 1620, datë 13.04.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit.”

Në nenin 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ankesa nuk pranohet kur: .... (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijëni për sjelljen diskriminuese”. Parashikimi i sipërcituar nuk është kumulativ dhe kërkon si kriter për mospranimin e ankesës, plotësimin e njërit prej kushteve të mësipërme.

Referuar informacionit të cituar në ankesë rezulton se data e ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është 02.10.2014, fakt i cili është pohuar dhe nga vetë ankuesi. Ndërkohë që, edhe data e konstatimit të diskriminimit nga ana e ankuesit është 02.10.2014, datë të cilën ai e citon se ka marrë dijëni mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Për sa më sipër, KMD gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është data **02.10.2014**. Edhe momenti i marrjes dijëni nga ankuesi mbi sjelljen diskriminuese të pretenduar nga ana e Prefektit të Qarkut Durrës, është data **02.10.2014**. Ndërkohë që, data e depozitimit të ankesës pranë KMD-së është **22.05.2024**. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit daton më shumë se 3 (vjet) nga ndodhja e diskriminimit të pretenduar. Njëkohësisht, edhe momenti, i marrjes dijëni mbi diskriminimin e pretenduar, daton më vonë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr. 112, datë 22.05.2024 pranë KMD-së.

Pra, konkludojmë së janë tejkeluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronja dh), nenin 33, pika 10, nenin 36, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 112, datë 22.05.2024, së A. M., pasi është depozituar jashtë afateve ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Bindjet politike)

(Fusha: Punësim)